

## 017 IDENTIFIKUES TË TJERË

Fusha përmban treguesin e lidhur me entitetin e vendosur në fushën 2XX, që nuk i përshtatet asnjë fushe tjetër dhe shpjegimin, që bënë definimin shtesë të treguesit, kur në regjistrim ekzistojnë disa. Fusha përmban edhe burimin e treguesit.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
017	Identifikues të tjerë	r
a	<i>Identifikuesi</i>	nr
b	<i>Shpjegimi</i>	nr
z	<i>Identifikuesi i gabuar</i>	r
2	<i>Kodi i sistemit</i>	nr

### Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<b><i>Lloji i identifikuesit</i></b>
	7	<i>sistemi, i përcaktuar në nënfushën 2</i>
	8	<i>lloji i identifikuesit nuk është përcaktuar</i>
2		<b><i>Nuk është i përcaktuar</i></b>

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 017a Identifikuesi

Identifikuesi; forma varet nga sistemi prej të cilit është marrë identifikuesi.

### 017b Shpjegimi

Shpjegimi për identifikuesin në nënfushën a ose z.

### 017z Identifikuesi i gabuar

Identifikuesi, i cili te entitetet e caktuara është përdorur gabimisht, ose në një mënyrë tjetër është i pavlefshëm. Identifikuesi mund t'u jetë ndarë dy entiteteve të ndryshme dhe për këtë arsye është anuluar. Nëse identifikuesi i vlefshëm nuk dihet, në fushën 017 mund të jetë e pranishme vetëm nënfusha z.

---

## 0172 Kodi i sistemit

Kodi i sistemit nga i cili është marrë identifikuesi.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Identifikuesit e tjerë janë uniformë, të përhershëm dhe kode alfanumerike të pranuar ndërkombëtarisht, që përdoren për identifikimin e entitetit. Strukturën e identifikuesve e vendosin institucionet që i përcaktojnë ata.

Nënfusha 2 përdoret vetëm kur treguesi i parë ka vlerën "7" – sistemi, i përcaktuar në nënfushën 2.

## SHEMBUJ

1.

017	7□	a0000-0002-8038-722X 2orcid (Identifikuesi ORCID (Open Researcher and Contributor Identifier) për kërkuesin shkencor Leon Cizl.)
-----	----	---